



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4720 Prot.

Lezhë, më 19.03.2021

VENDIM

Nr. 49 Datë 17 . 03 . 2021

“Për

Përcaktimin e strukturës së banimit të banesave individuale për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit të cilët kanë zgjedhur që rindërtimi i banesave të tyre të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 të bëhet nga autoriteti shtetëror i caktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimit nr. 887, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.115, datë 26.08.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.141, datë 14.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.17, datë 03.02.2021 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindertimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (Pallate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”Vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë nr.18, datë 04.02.2021 “Për përcaktimin e vlerave për përfituesit e grantit të rindertimi, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit

me nivel dëmsh DS4 dhe DS5 dhe duhet të rindërtohen nga e para”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Përcaktimin e strukturës së banimit të banesave individuale për subjektet përfituese të grantit të rindërtimit të cilët kanë zgjedhur që rindërtimi i banesave të tyre të dëmtuara nga termeti i datës 26.11.2019 të bëhet nga autoriteti shtetëror i caktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

